

URDHËR
Nr.41, datë 9.5.2006

**MBI ZËVENDËSIMIN E LEJEDREJTIMEVE TË AUTOMJETEVE, TË LËSHUARA NË
REPUBLIKËN E KORESË**

Në zbatim të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës dhe pikës 2, neni 134 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”

URDHËROJ:

1. Në kushte reciprociteti, lejedrejtimet e automjeteve, të lëshuara në Republikën e Koresë, mund të zëvendësohen me ato të lëshuara në Republikën e Shqipërisë.

2. Lëshimi i lejedrejtimit për zëvendësimin e lejedrejtimit të automjeteve, të lëshuara në Republikën e Koresë, bëhet sipas përcaktimeve të nenit 134 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të lëshojë vetëm lejedrejtime të kategorisë B, për zëvendësimin e të gjitha llojeve të lejedrejtimit të automjeteve, të lëshuara në Republikën e Koresë.

4. Lejedrejtime të motomjeteve, Class 2/Motorcycles dhe Class 2/Small, të lëshuara në Republikën e Koresë, nuk do të zëvendësohen me lejedrejtime të motomjeteve, kategoria A.

5. Tipet e lejedrejtimit të lëshuara në Republikën e Koresë, bashkëlidhur, janë pjesë e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT**
Lulzim Basha